



Pranuar / Dorezuar / Prijmljeno / Prudato / Received / Delivroy	16 . 11 2021	viti / god / year	
Organ / Njësia / Organ / Jednica / Org / Unit	Nr Prot / Br Prot / Prot No	Shtojta / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
KPMISHCK	5474/2021		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOS

A.nr.848/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti, anëtarë, si dhe me Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 848/2021 të datës 04.10.2021 të parashtruar nga grup ankuesish dhe të cilët me autorizim i përfaqëson avokat Leci, nga Prishtina, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "*Kompensim Material*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 16.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.848/2021 e datës 04.10.2021, e parashtruar nga grup ankuesish dhe

A r s y e t i m

Ankuesit dhe nëpunës civilë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, nëpërmjet përfaqësuesit të tyre me autorizim avokat më datë 04.10.2021 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 685 të datës 20.09.2021, të Komisionit të Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për mos ekzekutim të kompensimit të shpenzimeve për ushqim-shujtës ditore duke filluar nga data 01.01.2015 deri me 31.12.2018.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHC), më datë 20.10.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek organi i punësimit, ndërsa KPMSHCK me datë 27.10.2021, ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 848/2021 të datës 04.10.2021 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 685 të datës 20.09.2021, të Komisionit të Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, E-mailin nga A.Sh.G. për A.L. i datës 21.09.2021; Vërtetimin mbi pranimin e dërgesës i datës 20.08.2021; Kërkesën e datës 19.08.2021; Autorizimin e datës 30.04.2021, nga _____ për avokatin _____ Vërtetim me Nr. 58 të datës 23.04.2021; Autorizimin e datës 30.04.2021, nga _____ për avokatin _____ Vërtetimin me nr. 89 i të datës 07.05.2021; Përgjigjen në ankesë të datës 27.10.2021; Akt Emërimit të datës 06.09.2019; Vlerësim i titullit të punës dhe koeficientit të pagës nga Ministria e Administratës Publike i datës 07.06.2019; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 20.08.2018; e-mailin e datës 16.01.2021, Ndryshim dhe Plotësim të aktit të Emërimit me numër 303/2018 të datës 06.09.2018

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha provave të parashtruar nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesve është *e pa bazuar, sepse:*

Nga shkresat e lëndës Kolegji ka konstatuar se ankuesit janë nëpunës civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe mbajnë pozitën e punës Zyrtar për Politika të Personelit, në kuadër të Divizionit Për Menaxhimin e Sistemit të Informatave të Burimeve Njerëzore.

Ankuesit, përmes përfaqësuesit me autorizim av. _____ me datë 20.08.2021 kanë parashtruar kërkesë të Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, për njohje të së drejtas për kompensimin e shpenzimeve për ushqim ditor për periudhën nga 01.01.2015 deri 31.12.2018.

Lidhur me shqyrtimin e kërkesës në fjalë, Komisioni i Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme përmes Vendimit me numër protokolli 658/201 të datës 20.09.2021 është shpallur jo kompetent për vendosje lidhur me ankesën/kërkesën e datës 20.08.2021, duke udhëzuar ankuesit që të parashtrojnë ankesë drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Grup ankuesish në afat ligjor respektivisht me datë 04.10.2021, përmes përfaqësuesit me autorizim kanë parashtruar ankesë në KPMSHCK, me pretendimin ankimor se punëdhënësi në kundërshtim me Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive nuk ka bërë kompensimin e shpenzimeve për ushqim ditor në vlerë prej 2€ në ditë dhe në këtë mënyrë ka shkelur të drejtat që burojnë nga marrëdhënia e punës. Me tej, propozojnë që KPMSHCK-ja të aprovoj ankesën duke i njohur të drejtën e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit-shujtës ditore në vlerë prej 2 € në ditë, duke filluar nga data 01.01.2015 deri me 31.12.2018.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesve dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014, ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhë jo me shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017.



Bazuar në këtë konstatim, dhe në kuptim të nenin 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, Kolegji konstaton se kërkesa e ankuesve për realizimin e kompensimit të shpenzimeve për ushqim gjatë punës, shujtave ditore për vitin 2015, 2016, dhe 2017 është parashkruar, kështu që pretendimi ankimor i ankuesve mbi këtë bazë ligjore është i pa bazuar.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda Nr. A. Nr. 848/2021

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-Demi


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueseve avokatit
- Sekretuarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Arkivit të KPMSHCK-së